R.I.Nr.2126/12

**Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik,Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri** me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehures Nadire Mici nga Hani Elezit , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par l.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithe personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 19.11.2013 merr këtë;

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. Dep. Dep. DPK/DMP
Nr. Prot Br.Prot. Prot No. 03-4065/13
Nr. I faq. Broj stranica 04
Data Datum 25.11.2013
PRISHTINE

**A K T V E N D I M**

E pandehura Nadire ( Sali ) Mici ,e lindur me dt.15.11.1981 ne Han te Elezit ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptare, shtetase e Republikes se Kosoves, e martuar ,prind I nje femije ,ka te kryer fakultetin , keshilltare komunale ne Asamblene komunale ne Han te Elezit ,e gjendjes së mesme ekonomike,

**Ë sht ë për gje gj ë s e**

Sepse si zyrtare e larte publike ne poziten e keshilltares komunale ne Asamblene Komunale ne Han te Elezit ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me daten 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithe personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithe personat zyrtare,

**D E N O H E T**

**Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj** në afat prej 15(pesëmbëdhjete ) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.l të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'I llogariten nga 15 (Njëzet ) € .

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumën prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.